



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:043145

Datë: 07.02.2024

Numri i dokumentit: 05295383

KPPP.nr. 758/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbaremore të kreditorit “Seti Commerc” Sh.P.K., me seli në Suharekë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit L.B., avokat nga Suhareka, kundër debitorit “Mullallari” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810083527 dhe seli në Prizren, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbaremore P.nr. 171/23, i lejuar me datë 14.04.2023, nga Përmbareuesi Privat Liridon H. Tërshani me seli në Prizren, jashtë seancës, me datë 07.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Mullallari” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810083527 dhe seli në Prizren, ashtu që Urdhri Përmbaremore P.nr. 171/23, i lejuar me datë 14.04.2023, nga Përmbareuesi Privat Liridon H. Tërshani, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e Faturës nr. 23-SHV01-005-59, e datës 05.04.2023, ka lejuar Urdhrin Përmbaremore P.nr. 171/23, të datës 14.04.2023, me të cilin është detyruar debitori, që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, kreditorit t’ia kompensoj në emër të faturës shumë prej EUR 31,939.00, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e arritshmërisë për pagesë, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbaremore në lartësi prej EUR 208.00.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me arsyetimin se e ka përmbushur obligimin ndaj kreditorit, ku nga lista e blerjeve dhe llogaria e debitorit shihet qartë se me datë 27.07.2022 ka bërë pagesë në shumë prej 15,476.00 €, si dhe me datë 23.08.2022 pagesë në shumë prej

16,730.00 €, e të cilat dëshmi të pagesave i ka bashkangjitur edhe në prapësimin e paraqitur. Meqenëse debitori ka bërë kompensimin e detyrimit ndaj kreditorit, i ka propozuar gjykatës që të anuloj urdhrin përmbarimor.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigje në prapësim ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim se ka përmbushur obligimet e tij ndaj kreditorit, të cilat pretendime janë të pabazuara për faktin se faturat të cilat pretendon që i ka përmbushur janë të vitit 2022, ndërsa propozimi për përmbarim është iniciuar me datë 05.04.2023 sipas faturës së datës 05.04.2023. Më tej, ka theksuar se fatura është pranuar me rregull dhe borxhi është në tërësi borxh i ri e që nuk ka të bëjë me pretendimet e debitorit që është thirrur në prapësimin e tij. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhrin përmbarimor ta vërtetojë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa, pika 1.3 e njëjtit nen ka përcaktuar faturën si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, në paragrafin 3 të këtij neni është përcaktuar se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anën tjetër, me nenin 37 të LPP-së parashihet se: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti, përkatësisht fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për arsye se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet se fatura në fjalë është dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se e njëjta është pranuar nga debitori, për arsye se faturës i mungon nënshkrimi apo vula e pranimit të debitorit. Ndërsa, në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmojë se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme ia ka dorëzuar debitorit,

ndërsa ky i fundit ka pranuar faturën në fjalë dhe se është pajtuar më përmbajtjen dhe lartësinë e të njëjtës. Rrjedhimisht, fatura si e tillë rezulton të jetë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori, andaj edhe nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm.

Gjykata ka vlerësuar edhe komunikimet elektronike të bashkangjitura në propozim për përmbartim përmes së cilave kreditori ka pretenduar se fatura i është dorëzuar debitorit, mirëpo gjen se dorëzimi i faturës në adresën elektronike të debitorit, nuk mund të konsiderohet dorëzim i rregullt përderisa sa kreditori nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi se fatura është pranuar nga debitorit, përkatësisht se i njëjti ka konfirmuar pranimin e email-it me përmbajtjen e faturës mbi bazën e së cilës është iniciuar procedura përmbartimore.

Andaj, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilës Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 71, pika 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 758/23, datë 07.02.2024

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.